

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“G & E FRUITS” SHPK**

Në Elbasan, sot me datë 01.02.2019, u paraqitën personalisht ortakët themelues si më poshtë :

**Z.Gazmir Bullari**, i biri i Shefqetit, lindur me 13.10.1981 në Cërrik, Elbasan dhe banues në Cërrik, Elbasan, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pashaportën me nr.personal **I 11013143 K** dhe nr.pashaporte **BA5411237**, dhe

**Z.Fran Leka** lindur në Omar, Shkodër me 22.05.1961 dhe banues në Shkodër madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pashaportën me nr.personal **G 10522089 H** dhe nr.pashaporte **BR 0145293**

të cilët hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë “**G & E FRUITS**” SHPK, mbështetur në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte :

**Kreu 1**

**Neni 1**


**Krijimi**

Shoqëria “**G & E FRUITS**” SHPK, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.



Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria “G & E FRUITS” SHPK, është një shoqëri, që themelohet nga ortakët e saj dhe që përballon humbjen vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 3

#### Selia

Selia e shoqërisë “G & E FRUITS” shpk është në adresën Rruga “Cerrik-Belsh”, Km.3, Zona kadastrale Nr.2281, Cerrik, Elbasan.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësimi, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është **veprimtari kryesisht në fushën frutikulturë dhe agropërpunim:**

- Mbjellje e pemëve të ndryshme në qarkun e Elbasanit;
- Tregtim me shumicë e pakicë e fidaneve të ndryshëm;
- Tregtim me shumicë e pakicë i produkteve të prodhuara;
- Pëpunimi dhe ambalazhimi i produktit të gatshëm sipas standarteve;
- Importim i fidaneve të llojeve të ndryshme;
- Eksport të produktit të gatshëm;
- Shërbime të ndryshme në fushën e hotelërisë dhe agroturizmit;

### Neni 5

#### Kohëzgjatja



Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë “G & E FRUITS” SHPK është e pakufizuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë. Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë si dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrin ortakët e saj.

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 200.000 (dyqindmije) lekë i formuar tërësisht nga ortakët e saj.

Ky kapital është ndarë në 1(një) kuotë me vlerë nominale prej 100.000 (njëqindmijë) lekë për ortakun Z.Gazmir Bullari dhe në 1(një) kuotë me vlerë nominale prej 100.000 (njëqindmijë) lekë për ortakun Z.Fran Leka dhe të dy së bashku janë zoterues të 100% te kapitali themeltar.


Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotave të shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjeteve nga çasti i cënimit.

#### Neni 7

##### Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :



- a) Kontributet në kapitalin e shoqërisë
  - b) Shitblerjes
  - c) Trashëgimisë
  - d) Dhurimit
  - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
  3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
  4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe moment i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotave hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### KREU III

## ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

### Neni 8


#### Organi Vendimmarrës

Ortakët janë i vetmi organi vendimmarrës të shoqërisë.

Ortakët janë i vetmi organi vendimmarrës të shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortakët janë i vetmi organi vendimmarrës i shoqërisë që janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;



- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i) Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.


Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakut ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## Neni 9

### Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga Z.Gazmir Bullari sipas statutit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte ripërteritje.



Ortakët mund të shkarkojnë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratorët shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjerit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.


## Neni 10

### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjithë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- d) Përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dhe i paraqesin këto dokumente përpara asamblëse së përgjithshme për miratim;
- e) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryejë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) Raportoje përpara asamblëse së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publikë dhe /ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi



ketu autoritetet gjyqesore te gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te punes, Autoriteteve Doganore, etj, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te trete nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

#### Neni 13


##### Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKËT E SHOQËRISË “G & E FRUITS” SHPK**

**GAZMIR BULLARI**

**FRAN LEKA**

  
7

